



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 856/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e paraqitur nga Lulzim Neziraj, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Shtime, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht i bazuar apeli Anr.856/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga Lulzim Neziraj, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Shtime, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet e kandidatëve për Kuvendin Komunal në Shtime nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në Vendvotimet: 2201E/03R; 2201E/04R; 2201E/05D; 2201X/01R; 2201X/02R; 2201X/03R; 2201X/04R; 2201X/05D; 2202E/01R; 2202E/02R; 2202E/03D; 2203E/01R; 2202E/02D; 2204E/02D; 2205E/01D; 2206E/02R; 2206E/03R; 2206E/04D; 2207E/01R; 2207E/02D; 2208E/01D; 2209E/01R; 2209E/02D; 2210E/01D; 2212E/01D; 2213E/01R; 2213E/02D; 2214E/01D; 2215E/02D; 2216E/01D; dhe Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

III. Refuzohet e pabazuar pjesa e apelit paraqitur nga Lulzim Neziraj, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Shtime me të cilën ka kërkuar rinumërimin, për vendvotimet: 2201E/01R; 2201E/02R; 2206E/01R; 2215E/01R.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.856/2021 nga Lulzim Neziraj, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Shtime, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në të cilën pretendon se nga shpallja e rezultateve të KQZ-se për Kuvendet Komunale i njëjti ka 245 vota mirëpo sipas dëshmimeve të Formularëve të Publikuar të KQZ-se rezulton se që gjithsej ka 251 vota. Si dëshmi ka bashkangjitur kopjet e Formularëve të Rezultateve të Kandidateve

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, pas shqyrtimit të pretendimeve të apelit, materialit zgjedhor dhe provave që gjinden në shkresat e lëndëve, gjeti se:

apeli është pjesërisht i bazuar.

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, siç rezulton edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vete pala ankuese, andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatin nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Shtime për Vendvotimet: 2201E/03R; 2201E/04R; 2201E/05D; 2201X/01R; 2201X/02R; 2201X/03R; 2201X/04R; 2201X/05D; 2202E/01R; 2202E/02R; 2202E/03D; 2203E/01R; 2202E/02D; 2204E/02D; 2205E/01D; 2206E/02R; 2206E/03R; 2206E/04D; 2207E/01R; 2207E/02D; 2208E/01D; 2209E/01R; 2209E/02D; 2210E/01D; 2212E/01D; 2213E/01R; 2213E/02D; 2214E/01D; 2215E/02D; 2216E/01D dhe rezultati i dalur nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të vitit 2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës se

lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Apeli në pikën III të dispozitivit është i pa bazuar për arsye se nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, kërkon rinumërimin e votave për vendvotimet: 2201E/01R; 2201E/02R; 2206E/01R; 2215E/01R, është i pa bazuar për faktin se për të njëjta vendvotime, KQZ-ja veç ka marrë vendim për rinumërim para se rezultati përfundimtar të publikohet andaj të njëjtat janë të rinumëruara, për këto arsye paneli vlerëson se një rinumërim tjetër për të njëjtat vendvotime të rinumëruara nga KQZ-ja në QNR, është i pa arsyeshëm, për më tepër ankuesi nuk ka ofruar prova shkresore që do ta argumenton se parregullsitë kanë ndodhur me rastin e rinumërimit andaj si të tilla këto pretendime janë të paqëndrueshme.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.856/21 më datë 06.11.2021

Kryesuesi i Panelit
Ferki Xhatër



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.